



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 94

Tiranë – E mërkurë, 3 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 55/2017 datë 13.4.2017	Për ratifikimin e ndryshimit nr. 1 të marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria Ag, lidhur me financimin e projektit “Shëndetësia elektronike në Shqipëri - regjistri mbarëkombëtar i shëndetësisë elektronike”, ratifikuar me ligjin nr. 69/2014.....
	5311
Vendim i Kuvendit nr. 51/2017 datë 27.4.2017	Për miratimin e fondit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017.....
	5314
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 21, datë 12.4.2017	Për miratimin e rregullores “Për zbatimin e nënprogramit të Mbështetjes Financiare për ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM)”, Programi i Mbështetjes për Ekonominë, shtylla III.....
	5314



LIGJ
Nr. 55/2017

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NR. 1
TË MARRËVESHJES SË KREDISË PËR
EKSPORT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, QË PËRFAQËSOHET NGA
MINISTRIA E FINANCAVE, DHE
UNICREDIT BANK AUSTRIA AG,
LIDHUR ME FINANCIMIN E
PROJEKTIT “SHËNDETËSIA
ELEKTRONIKE NË SHQIPËRI -
REGJISTRI MBARËKOMBËTAR I
SHËNDETËSISË ELEKTRONIKE”,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 69/2014**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe
121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi nr. 1 i marrëveshjes së
kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave
të Republikës së Shqipërisë, që përfaqësohet nga
Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria
AG, lidhur me financimin e projektit “Shëndetësia
elektronike në Shqipëri - Regjistri Mbarëkombëtar i
Shëndetësisë Elektronike”, ratifikuar me ligjin nr.
69/2014, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji
dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në
Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10224, datë
27.4.2017 të Presidentit të Republikës së
Shqipërisë, Bujar Nishani**

NDRYSHIM nr. 1

I DATËS 6 MARS/24 MARS 2017 PËR
MARRËVESHJEN E KREDISË PËR
EKSPORT HUA E BUTË NR.232.324 PËR
SHUMËN PREJ 13,995.000, E DATËS 11
QERSHOR/17 QERSHOR 2014 TË LIDHUR
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË EMËR
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE (HUAMARRËSI) DHE
UNICREDIT BANK AUSTRIA AG
(HUADHËNËSI) NË LIDHJE ME
FINANCIMIN E PROJEKTTIT “SHËNDETI
ELEKTRONIK NË SHQIPËRI – REGJISTRI
MBARËKOMBËTAR I SHËNDETTIT
ELEKTRONIK”

Ky Ndryshim nr. 1 (“**Ndryshimi nr. 1**”) lidhet
ndërmjet

1. **UniCredit Bank Austria AG**, Schottengasse
6 - 8, A-1010 Vjenë, Republika e Austrisë,
(Huadhënësi), nga njëra anë, dhe

2. **Këshillit të Ministrave të Republikës së
Shqipërisë në emër të Republikës së
Shqipërisë** dhe të përfaqësuar nga Ministria e
Financave, (**Huamarrësi**), nga ana tjetër.

Duke pasur parasysh se:

A. Huadhënësi dhe Huamarrësi kanë lidhur
marrëveshjen e kredisë së eksportit për hua të butë
nr. 232.324 për shumën prej 13,995,000 Euro të
datës 11./17 qershor 2014, (**Marrëveshja
fillestare**).

B. Huadhënësi dhe Huamarrësi kanë lidhur një
Ndryshim Nr. 1 më 11 janar/13 shkurt 2017 dhe
kanë rënë dakord që Ndryshim Nr. 1 i lidhur më
datë 11 janar/13 shkurt 2017 nuk do të bëhet
efektiv, dhe do të zëvendësohet me këtë Ndryshim
Nr. 1.

C. Huadhënësi dhe Huamarrësi bien dakord të
zgjatnin periudhën e disponueshmërisë dhe të
ndryshojnë Marrëveshjen fillestare në lidhje me
termat dhe kushtet e përcaktuara më poshtë:

Është rënë dakord si më poshtë:

1. Përkufizimet

Termat e përcaktuara në Marrëveshjen fillestare,
nëse e kërkon konteksti dhe nëse nuk specifikohet
ndryshe në këtë dokument, do të kenë të njëjtin
kuptim në këtë Ndryshim nr.1.



Përveç kësaj, në këtë Ndryshim nr.1 termat e mëposhtme kanë kuptimet e dhëna në klauzolën 1:

“**Hyrja në Fuqi**” nënkupton datën në të cilën Huadhënësi i konfirmon Huamarrësit që ka marrë secilin nga dokumentet e renditura në klauzolën 4 të Ndryshimit nr.1 (Kushtet Paraprake) në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin.

2. Ndryshimet

Palët e këtij Ndryshimi nr.1 bien dakord që në lidhje me Hyrjen në Fuqi Marrëveshja fillestare do të ndryshohet si më poshtë:

Pika 2. (Periudha e Disponueshmërisë (pjesa 2.2) e Aneksit 3 të Marrëveshjes fillestare do të ndryshohet si më poshtë:

“2. Periudha e Disponueshmërisë (Seksioni 2.2)

Nga Data e Mbylljes (siç përcaktohet në pjesën 7) deri më 31.05.2017 ose çdo datë më pas siç mund të bien dakord Huadhënësi dhe Huamarrësi.

3. Garancitë

Huamarrësi, nëpërmjet këtij dokumenti, garanton se në datën e këtij dokumenti dhe në datën e Hyrjes në Fuqi garancitë e përcaktuara në Seksionin 9.1 (Garancitë) të Marrëveshjes fillestare janë të vërteta dhe të sakta siç janë hartuar nga Huamarrësi në ato data.

4. Kushtet Paraprake

Huadhënësi do të ketë marrë:

a) kopjen origjinale të këtij Ndryshimi nr. 1 të nënshkruar siç duhet nga Huadhënësi dhe nga një person ose persona të autorizuar për të nënshkruar dhe dorëzuar këtë ndryshim Nr.1 për dhe në emër të Huamarrësit dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

b) modele nënshkrimesh të vërtetuara (të certifikuara dhe konfirmuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave) të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar dhe dorëzuar këtë Ndryshim nr.1 për dhe në emër të Huamarrësit;

c) identifikime nëpërmjet fotove (të certifikuara dhe konfirmuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave) të personit ose personave të autorizuar për nënshkrimin dhe dorëzimin e këtij Ndryshimi nr.1 për dhe në emër të Huamarrësit; dhe

d) një opinion ligjor të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë në formë dhe përmbajtje të pranueshme të Shtojcës 1 (Opinionit Ligjor) të këtij dokumenti.

5. Të ndryshme

Nga Hyrja në Fuqi ky Ndryshim nr.1 do të jetë pjesë integrale e Marrëveshjes fillestare dhe shprehja ‘kjo Marrëveshje’ në Marrëveshjen fillestare do të nënkuptojë Marrëveshjen fillestare të ndryshuar sipas këtij Ndryshimi nr.1.

6. Ligji Rregullues dhe Arbitrazhi

a) Ky Ndryshim Nr.1 do të rregullohet nga ligjet e Republikës së Austrisë, duke përfshirë rregullat e konfliktit të ligjeve.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin në lidhje me këtë Ndryshim nr 1, duke përfshirë lidhjen e saj, vlefshmërinë dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen përfundimisht nga tre arbitra sipas Rregullave të Pajtimit dhe Arbitrazhit, në atë kohë në fuqi, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

c) Vendi i arbitrazhit është Parisi. Gjuha e përdorur në procedimet e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.

d) Vendimi i arbitrazhit përcakton përgjegjësinë e palëve për shpenzimet e shkaktuara nga palët.

e) Arbitrat do të bëjnë çdo përpjekje për të kryer procedimet dhe për të përgatitur vendimin e tyre në mënyrë që ta bëjnë vendimin të zbatueshëm sipas ligjit.

f) Gjykimi mbi dhënien e vendimit mund të zhvillohet në çdo gjykatë që ka juridiksion ose në atë gjykatë mund të bëhet kërkesë për një pranim gjyqësor të vendimit dhe urdhër ekzekutimi, sipas rastit.

g) Nëse Huadhënësi merr masa ligjore (duke përfshirë padinë, arbitrazhin, sekuestrimin, ekzekutimin ose ndonjë masë tjetër zbatuese ose mbrojtëse) kundër Huamarrësit në lidhje me ndonjë çështje që lind sipas këtij Ndryshimi nr.1, Huamarrësi në këtë mënyrë heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që mund të ketë Huamarrësi.

Përfundimisht, Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti mbi ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi në lidhje me:

i) "ambientet e tashme ose të ardhshme të misionit", siç përcaktohet në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatieke të nënshkruar në vitin 1961, ‘ambientet të tashme ose të ardhshme konsullore’, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në vitin 1963, ose të përdorura ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;



ii) çdo pasuri e paluajtshme që përmendet në nenin 3, paragrafët 1-3, të Ligjit shqiptar nr. 8743 të datës 22.2.2001 “Mbi Pasuritë e Paluajtshme Shtetërore”;

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë të kërkueshme në momentin e ekzekutimit, që është caktuar për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas të drejtës publike ndërkombëtare.

7. Përfshirja e Termave

Seksioni 11.1 (*Njoftimet*), Seksioni 11.3 (Heqjet dorë, mjetet mbrojtëse kumulative) dhe Seksioni 11.7 (Ndryshimet e Marrëveshjes) të Marrëveshjes fillestare janë të përfshira këtu, me referencë në këtë Ndryshim nr.1 me të njëjtin efekt sikur të njëjtat pjesë të jenë të përcaktuara në mënyrë të plotë ‘mutatis mutandis’ në këtë Ndryshim nr.1 dhe sikur referencat në ato pjesë nga “kjo Marrëveshje” të jenë referenca të këtij Ndryshimi nr.1.

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar nëpërmjet personave të autorizuar këtë Marrëveshje nr.1 në datën/vitin e shënuar fillimisht më sipër në dy kopje origjinale.

Për dhe në emër të

UniCredit Bank Austria AG

Nënshkrimi

.....

Vendi, data: Vjenë

Për dhe në emër të

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqëson nga Ministria e Financave

Nënshkrimi

Vula

Emri, pozicioni

Vendi, data:

SHTOJCA 1

OPINIONI LIGJOR

[Letër me kokë të Republikës së Shqipërisë]

Nga:

Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë

[adresa]

Për: UniCredit Bank Austria AG

Në vëmendje të: Ms. Heidemarie Wagner

8243/ Structured Trade & Export Finance

Schottengasse 6-8

A-1010 Vienna, Austria

Datë,

Unë,, duke vepruar në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, i referohem ndryshimit nr.1 të datës [.....] 2016 (Ndryshimi nr.1) të marrëveshjes së kredisë të eksportit për një hua të butë nr. 232.640 për një shumë prej 13,995,000 Euro datë 11./17 qershor 2014 (Marrëveshja fillestare) dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqëson nga Ministria e Financave si Huamarrës (‘Huamarrës’) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënës (‘Huadhënës’).

Kam shqyrtuar kopjen e nënshkruar të Marrëveshjes fillestare, Ndryshimi nr.1 dhe dokumente të tjera që i kam çmuar të nevojshme dhe të përshtatshme, me qëllim që të mund të jap këtë opinion. Afatet e përcaktuara në Marrëveshjen fillestare kanë të njëjtin kuptim, në këtë dokument.

Unë nëpërmjet kësaj konfirmoj që:

i) Z. [.....] (emri i personit nënshkrues) është autorizuar për të nënshkruar dhe dorëzuar Ndryshimin nr.1.

ii) Janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme (qeveritare dhe të tjera) të kërkuara me ligj për të autorizuar ekzekutimin e duhur, shpalljen dhe realizimin e Ndryshimit nr.1 dhe për të vendosur detyrimin ligjor ndaj Huamarrësit.

iii) Nuk është e nevojshme ose e këshillueshme që Ndryshimi nr. 1 të depozitohet, ruhet ose regjistrohet nëpërmjet ndonjë autoriteti tjetër qeveritar ose agjencie tjetër në Republikën e Shqipërisë me qëllim për të garantuar ligjshmërinë, vlefshmërinë, zbatueshmërinë ose pranueshmërinë si dëshmi të Ndryshimit nr.1 dhe të Marrëveshjes fillestare të ndryshuar sipas Ndryshimit nr.1.



iv) Ndryshimi nr.1 dhe Marrëveshja fillestare e ndryshuar nga Ndryshimi nr.1 përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin, të zbatueshme në përputhje me kushtet përkatëse.

Unë nuk shpreh asnjë opinion në lidhje me ligjet e një juridiksioni të ndryshëm nga ai i Republikës së Shqipërisë.

Me respekt,

Nënshkrimi i autorizuar
Emri dhe funksioni/ vula

VENDIM

Nr. 51/2017

PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR FINANCIMIN E PARTIVE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË VITIT 2017

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, dhe të nenit 87, pika 1, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Sasia e fondit nga Buxheti i Shtetit, që do t'u ndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, është 65 milionë lekë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 27.4.2017

VENDIM
Nr. 21, datë 12.4.2017

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ZBATIMIN E NËNPROGRAMIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME (NMVM)”, PROGRAMI I MBËSHTETJES PËR EKONOMINË, SHTYLLA III

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 e të aneksit 3, të ligjit nr. 130 datë

15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017” dhe të nenit 9 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 03.08.2016, “Për krijimin e Programit për Mbështetjen e Ekonomisë dhe përcaktimin e përfituesve e rregullave për zbatimin e tij”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të priorizimit të zonave të përmirësuara të biznesit, të pranueshme për aplikim, për thirrjen e parë të vitit 2017, sipas aneksit 1, bashkëlidhur.

2. Miratimin e rregullores “Për zbatimin e Nënprogramit të Mbështetjes Financiare për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM)”, Programi i Mbështetjes për Ekonominë, shtylla III.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si edhe Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



ANEKSI 1

Për prioritizimin e zonave të përmirësuara të biznesit, të cilat do të jenë të pranueshme për aplikim, për thirrjen e parë të vitit 2017 për nënprogramin e mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), Programi i mbështetjes për ekonominë, shtylla III, do të aplikohen kriteret sipas tabelës në vijim:

Nr	Kriteret	Vlerësimi
1	Aplikimi minimal, 10% e bizneseve potenciale të zonës	1 – 20 pikë
2	Zonat të lidhura me zinxhirin e vlerës	1 – 20 pikë
3	Shkalla e përfundimit të infrastrukturës publike	1 – 20 pikë
4	Hapësira të lira për njësitë e reja ekonomike	1 – 20 pikë
5	Bashkëfinancim i donatorëve të tjerë	1 – 20 pikë
TOTALI:		100 pikë



RREGULLORE PËR ZBATIMIN E NËNPROGRAMIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NDËRMARRJET MIKRO TË VOGLA DHE TË MESME (NMVM)

Kjo rregullore përcakton specifikimet, rregullat dhe format për aplikim, si dhe kriteret e vlerësimit të aplikuesit për nënprogramin “Për mbështetjen financiare për ndërmarrjet, mikro, të vogla dhe të mesme”, në programin “Mbështetje për ekonominë”, të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

1. Aplikuesit e mundshëm

1.1. Për skemën e parë “Mbështetje për NMVM për krijimin e zonave të përmirësuara të biznesit”, mund të aplikojnë ato subjekte, që ndodhen brenda zonës së përmirësuar të biznesit¹, të përcaktuar për mbështetje, në programin e Mbështetjes për Ekonominë, që klasifikohen si sipërmarrje mikro, të vogla apo të mesme, që plotësojnë kushtet sipas legjislacionit në fuqi dhe që provojnë mundësinë e bashkëfinancimit të 50% të kostove të projektit, që zbatohet në zonat e përmirësuara të biznesit, që mbështet granti.

1.2. Për skemën e dytë “Mbështetje për projekte të njësive ekonomike të njësive të qeverisjes vendore”, mund të aplikojnë të gjitha subjektet, njësitë ekonomike (shoqëritë tregtare) që klasifikohen si sipërmarrje mikro, të vogla apo të mesme, sipas legjislacionit në fuqi, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, të cilat paraqesin projekte konkrete ekonomike zhvillimore, me impakt në ekonominë dhe zhvillimin lokal dhe rajonal, si dhe në gjenerimin e të ardhurave për njësitë e qeverisjes vendore dhe/ose rritjen e punësimit, me një plan biznesi të qartë, dhe që sigurojnë paralelisht bashkëfinancimin e 50% të kostove të projektit.

2. Njoftimi i thirrjes, informimi dhe ndihma për aplikim

- Njoftimi i thirrjes për aplikim bëhet, detyrimisht:
 - a. nëpërmjet shpalljes së njoftimit në zonën që mbështet nënprogrami;
 - b. nëpërmjet shpalljes së njoftimit online, në faqen zyrtare të AZHER.
- Informimi për thirrjen për aplikim mund të bëhet në bashkëpunim edhe me njësitë e qeverisjes vendore dhe AZHER, në vendet e ndërhyrjes, si dhe nëpërmjet mjeteve dhe formave të tjera, për të rritur numrin e aplikuesëve të mundshëm.
- Aplikimi bëhet:

1 Parashikuar në nënprogramin, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, nr. 14, datë 21.3.2017 “Për miratimin e financimit për grantin “Nënprogrami i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”, të programit “Mbështetje për ekonominë”, si dhe të kalendarit me datën e fillimit të aplikimeve, për vitin 2017”, aneksi 1, si dhe në pikën 1 të vendimit të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, nr.21, datë 12.4.2017 “Për miratimin e rregullores “Për zbatimin e Nënprogramit të mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”, programi i Mbështetjes për Ekonominë, shtylla III”.



- a. *Online*, në faqen elektronike të AZHER;
- b. Me shkresë zyrtare (me postë ose protokollim dorazi), pranë zyrave të Agjencisë.

Në rastin e aplikimeve dorazi, i gjithë dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrat e AZHER në 2 (dy) kopje të mbyllura, brenda afateve dhe orareve të caktuar.

Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER) mund të orientojë dhe asistojë plotësimin e dokumentacionit të kërkuar, me kërkesë të aplikuesit ose kryesisht në zonën që mbështet programi, përgjatë gjithë procesit të aplikimit, për të siguruar më tepër qartësi rreth programit.

3. Plotësimi i formularëve të aplikimit

Formularët e aplikimit publikohen *online* në faqen e internetit red.gov.al, si pjesë e paketës së aplikimit, së bashku me *Shpjeguesin për Aplikim*, të vënë në dispozicion nga AZHER.

Plani i biznesit do të përdoret për të vlerësuar në mënyrë sasiore një projekt propozim. Plani i biznesit hartohet nga vetë aplikuesi, megjithatë në raste të caktuara, stafi i AZHER mund të asistojë aplikuesit në plotësimin e formularit (sidomos në pjesën e llogaritjeve financiare).

Qëndrueshmëria e investimit të propozuar duhet të evidentohet qartazi në planin e biznesit. Në veçanti, aplikuesi duhet të demonstrojë kapacitetin dhe gatishmërinë për të vazhduar mbështetjen e aktivitetit edhe pas përfundimit të financimit me grant.

Të gjitha kërkesat për rimbursim duhet të identifikohen sipas formularëve përkatës, si dhe të dhënat e shpenzimeve duhet të jenë të sakta, realiste dhe lehtësisht të verifikueshme.

4. Marrja në dorëzim e aplikimit, pranimi i aplikimit

AZHER do të shqyrtojë paraprakisht aplikimin dhe dokumentet shoqëruese, për t'u siguruar që i gjithë dokumentacioni i nevojshëm është dorëzuar. Pas verifikimit, nëse të gjitha dokumentet janë dorëzuar sipas kërkesës, AZHER i komunikon aplikuesit pranimin e aplikimit, pajis atë me një numër unik aplikimi, si dhe njofton aplikuesin se aplikimi i pranuar kalon në fazën e vlerësimit për financim.

Nëse një aplikues nuk i ka dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme, AZHER mund t'i japë aplikuesit një afat deri në 5 ditë kalendarike, por gjithmonë brenda afatit të mbylljes së aplikimeve, për të plotësuar dokumentacionin e munguar.

Aplikimet e paplota, nuk do të kalojnë në fazën e vlerësimit.

Bashkëlidhur në këtë rregullore, gjenden, për të dyja skemat, shtojcat si më poshtë:

- I. Shpallja e thirrjes për aplikim;
- II. Formati i aplikimit
 - II.1. Formulari i Aplikimit
 - II.2. Modeli i planit të biznesit
 - II.3. Modeli i planit të investimit
 - II.4. Model i projeksionit të shitjeve pas investimit
- III. Kriteret e vlerësimit të aplikimeve (Skema 1 dhe skema 2)



Shtojca I: SHPALLJA E THIRRJES PËR APLIKIM

1.1. Aplikimi për skemën 1 “Mbështetje për NMVM për krijimin e zonave të përmirësuara të biznesit”

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Shpallja në: - zonën që mbështet nënprogrami - faqen zyrtare të AZHER	Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal	Hapja e thirrjes për aplikime për NMVM, skema 1, nënprogrami “Mbështetja financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”, programi “Mbështetje për ekonominë”
30 ditë kalendarike nga dita e shpalljes	Aplikuesit/subjektet e projektit që ndodhet brenda zonës së përmirësuar të biznesit (potenciale), që mbështet thirrja përkatëse	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi online në faqen elektronike të Agjencisë: https://www.red.gov.al ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (dhe në CD) dërgohet pranë Agjencisë për Zhvillim Ekonomik Rajonal. Për çdo informacion të nevojshëm në lidhje me aplikimin <i>online</i> mund të kontaktoni: AZHER email: info@red.gov.al
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal	AZHER i konfirmon aplikuesit pranimin ose jo të aplikimit, si dhe e pajis atë me një numër unik aplikimi, për kalim në fazën e vlerësimit.

Shënim: Koha e zbatimit të investimit për të cilin bëhet aplikimi, është maksimumi 3 muaj para hapjes së thirrjes dhe deri në 4 muaj mbas hapjes së thirrjes.

1.2. Aplikimi për skemën 2 “Mbështetje për projekte të njësive ekonomike të njësive të qeverisjes vendore”

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Shpallja në: - zonën që mbështet nënprogrami - faqen zyrtare të AZHER	Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal	Hapja e thirrjes për aplikime për të gjitha njësitë ekonomike të njësive të qeverisjes vendore, skema 2, nënprogrami “Mbështetja financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”, programi “Mbështetje për ekonominë”
30 ditë kalendarike nga dita e shpalljes	Njësitë ekonomike (shoqëritë tregtare) që klasifikohen si sipërmarrje mikro, të vogla apo të mesme, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi online në faqen elektronike të Agjencisë: https://www.red.gov.al ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (dhe në CD) dërgohet pranë Agjencisë për Zhvillim Ekonomik Rajonal. Për çdo informacion të nevojshëm në lidhje me aplikimin <i>online</i> mund të kontaktoni: AZHER email: info@red.gov.al
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal	AZHER i konfirmon aplikuesit marrjen e dokumentacionit dhe e pajis atë me një numër unik aplikimi.

Shënim: Financimi i kësaj skeme i nënshtrohet rregullave dhe procedurave të financimit publik.



Shtojcë II: FORMATI I APLIKIMIT

II.1. Formulari i aplikimit

Aplikuesi/Emri i Subjektit:			
Personi përgjegjës/Administratori: tel., e-mail, adresë:			
NUIS:			
Forma ligjore:			
Madhësia e biznesit ² (Ndërmarrje) :	☐ Mikro	☐ Vogël	☐ Mesëm
Fusha e veprimtarisë:			
Data e themelimit:			
Numri i punonjësve:			
Kapitali korrent:			
Vendi i ushtrimit të aktivitetit (adresa):		☐ Ambient me Qera	☐ Ambient në Pronësi
Bashkia/zona ku zbatohet:	Bashkia _____ Zona _____		

² NMVM janë të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara sipas nenit 4 të ligjit Nr. 8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme"

1. Ndërmarrjet, në kuptim të këtij ligji, klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme.

2. Mikrondërmarrjet janë ndërmarrjet, të cilat punësojnë deri në 5 punonjës.

3. Ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrjet, të cilat:

a) punësojnë 6-20 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 40 milionë leke;

c) 100 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të këtij ligji, klasifikohen si ndërmarrje të vogla.

4. Ndërmarrjet e mesme janë ndërmarrjet, të cilat:


a) punësojnë 21-80 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 80 milionë lekë;

c) më pak se 25 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të këtij ligji, nuk klasifikohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.



Ortakët:	1. _____ % 2. _____ % 3. _____ %
Emri i ekonomistit: Tel./Cel.:	
Lejet dhe licensat e zotëruara:	
Data e aplikimit:	
Titulli i projektit:	
Data e fillimit të projektit:	
Data e parashikuar për përfundimin e projektit:	
Përshkrim i projektit (biznesi, produktet apo shërbimet që do të ofrohen):	
Qëllimi i projektit:	
Analiza e tregut dhe e konkurrencës:	
Kontratë qiraje, marrëveshje për vendin e aktivitetit (Po/Jo , bashkëngjitur dokumenti):	
Përfshin <i>Design</i> /Projektim (Po/Jo):	
Qëndrueshmëria e projektit:	Të përshkruhet në mënyrë analitike kosto që aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kosto për operimin e aktivitetit dhe mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Specifikoni sa parashikohet të jenë këto kosto, si do të sigurohen etj.



	- Të specifikohet periudha në vite për kostot dhe të garantohet nga aplikuesi mbulimi i tyre.			
Skemat:	☐ Skema 1. Mbështetje për projekte të NMVM për krijimin e zonave të përmirësuara të biznesit		☐ Skema 2. Mbështetje për projekte të njësive ekonomike të njësive të qeverisjes vendore	
Vlera totale e investimit:				
Pjesa e financuar nga aplikuesi:	Përqindje	_____ %	Shuma	_____
	Mënyra e financimit:		Cash / Banke / Kredi	
Pjesa për t'u financuar me grant:	Përqindje	_____ %	Shuma	_____
Kërkesa për financim, sipas plani të biznesit (në lek):	Plani i biznesit			
	Projektimi teknik			
	Makineri/Paisje			
	Infrastrukturë biznesi			
	Të tjera...			
Faza e investimit:	☐ Investim i ri		☐ Investimi ka filluar prej _____ muajsh.	
Nr. i punonjësve të parashikuar pas zbatimit:				
Leje dhe licensa për t'u marrë:				
Probleme dhe pengesa:				
Deklarime:	i. Të gjitha të dhënat e paraqitura më sipër janë të vërteta, dhe konfirmoj se mbaj përgjegjësi të plotë personale në rast të deklarimeve të rreme, si dhe do të respektoj në mënyrë rigorozë të gjitha deklaratat e shprehura dhe angazhimet e përfshira në “Formularin e Aplikimit” dhe në “Planin e Biznesit”.		PO ☐	JO ☐
	ii. Pranoj të monitorohem nga personeli i AZHER, për një periudhë deri në një vit pas përfundimit të projektit, me qëllim krahasimin e progresit të realizuar me objektivat dhe shpenzimet e paraqitura në aplikim, si dhe/apo të auditohej duke siguruar të gjithë		☐	☐



	iii. informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar. Pranoj të paraqes pranë AZHER një raport në lidhje me përfundimin e projektit, faturat origjinale për shpenzimet (këto mund t'i kthehen sipërmarrjeve pasi të jenë nxjerrë kopjet e çertifikuara), si dhe çdo dokument të nevojshëm për të bërë të mundur kryerjen e pagesës. iv. Deklaroj se do të përfundoj projektin brenda kohës së parashikuar në kontratë.	☐	☐
Komente të tjera:			
Dokumente teknike:	1. Formulari i aplikimit; 2. Plani i biznesit; 3. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës së it; 4. Dokument/ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) (që përmban dhe NUIS) lëshuar jo më herët se 30 ditë përpara dorëzimit të aplikimit; 5. Fotokopje Licencës nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) për veprimtarinë e pranueshme (sipas listës së AZHER), në rastin kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi dhe nëse biznesi nuk është start-up; 6. Dokument që vërteton se nuk ka detyrime tatimore; 7. Vërtetim original ku provohet se i ka përmbushur detyrimet e pagesës së taksave (kontributet shoqërore, shëndetësore), lëshuar jo më herët se 30 ditë përpara dorëzimit të aplikimit; 8. Çertifikatë pronësie të objektit ku ushtrohet aktiviteti/ose kontratë qiraje me afat të paktën edhe 1 vit nga data e aplikimit për grant; 9. Deklaratë që dhënia e grantit do të administrohet në përputhje me qëllimet e nënprogramit përkatës.		

Xhiro vjetore (në lek)		Kapitali i shoqërisë (në lek)	
Viti aktual		Viti aktual	
Viti paraardhës		Viti paraardhës	
Para 2 vitesh		Para 2 vitesh	



Asete (në lek)		Detyrime ndaj furnitorëve (në lek)	
Toka dhe ndërtesa		Viti aktual	
Makineri dhe pajisje		Viti paraardhës	
Klient debitor		Para 2 vitesh	

*Aplikuesi**Vendi dhe data**(Emër, Mbiemër, Firmë)***Shënim: Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:**

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

- a) aplikimi *online* në faqen elektronike të Agjencisë për Zhvillim Ekonomik Rajonal: aplikimi *online* në <https://www.red.gov.al>

ose

- b) me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (dhe në CD) dërgohet pranë Agjencisë për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER).

2. Format i aplikimit duhet të dorëzohet i firmosur dhe i vulosur nga institucioni/subjekti aplikues.

Dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë detyrimsht i firmosur dhe i vulosur nga autorët përkatës.

**II.2. Modeli i planit të biznesit**

Emri i projektit:

1. Përmbledhje ekzekutive

1.1. Përshkrim i kompanisë / veprimtarisë;

1.2. Vizioni / misioni / vlerat

2. Përshkrim i projektit

2.1. Faktorët e suksesit, avantazhi konkurrues, qëllimi, tregu i synuar;

2.2. Objektivat (afatshkurtër 1-2 vjeçarë dhe afatmesëm 2-5 vjeçarë);

2.3. Zhvillimi ekonomik i zonës apo rajonit;

2.4. Punësimi i synuar;

2.5. Investitorët dhe partnerët.

3. Aneks

3.1. Plani i investimit;

3.2. Projektioni i shitjeve pas investimit.

*Maksimumi 150 fjalë për secilin kapitull***Hartuesi i planit të biznesit:**

EMER MBIEMER, FIRME

DATA

Deklaroj se të gjitha të dhënat e paraqitura më sipër janë të vërteta, dhe konfirmoj se mbaj përgjegjësi të plotë personale në rast të deklarimeve të rreme.

II.3. Model i Planit të Investimit (*excel*)³

PERSHKRIMI		LEKE
A. Plani i Biznesit		
1	Studime Tregu	
2	Plani Biznesit	
3	Llogari Financiare	
4	Plane Marketingu	
	TOTALI:	
B. Kosto Fillestare		
1	Rregjistrimi	
2	Taksa Tarifa Lokale	
3	Franchise / Blerje	
5	Leje / Autorizime	
	TOTALI:	
C. Kosto Operacionale		
1	Paga / Shpenzime	
2	Qera	
3	Sherbime (elektrike, uje..)	
4	Siguracione	
5	Blerje Produkte / Lende te para	
6	Blerje Mallra / Sherbime	
	TOTALI:	

PERSHKRIMI		LEKE
D. Projektme Teknike		
1	Studime nderhyrje	
2	Plane arkitektonike	
3	Plane inxhinierike	
	TOTALI:	
E. Makineri / Pajisje		
1	Mjete pune te aktivitetit	
2	Makineri prodhuese / paketuese	
3	Sisteme ngrohje / ftohje	
4	Sisteme sigurie	
5	Mobilje / pajisje arredimi	
6	Pajisje te tjera	
	TOTALI:	
F. Infrastruktura Biznesi		
1	Rrjeti Elektrik	
2	Rrjeti Hidraulik	
3	Rikonstruksion i brendshem	
4	Rikonstruksion i jashtem	
5	Infrastruktura Shoqeruese	
	TOTALI:	

- I. TOTALI I PËRGJITHSHËM I INVESTIMIT: _____
- II. KOSTO TË PARIMBURSUESHME _____
- III. KOSTO TË PRANUARA⁴: _____

³ Pikat A, D, E dhe F jane kosto të njohura, sipas VKM 580, datë 3.8.2016 "Për krijimin e programit për Mbështetjen e Ekonomisë, përcaktimin e fituesve e të rregullavë për zbatimin e tij". Kostot e tjera, të cilat nuk rimbursohen sipas VKM 580/2016, përballohen nga vetë i interesuari si pjesë e bashkëfinancimit prej 50%.

⁴ Pavarësisht llojit dhe sasisë së shpenzimeve, programi do të mbulojë jo më tepër se 50% të vlerës totale të projektit, brenda kostove të pranuar të paraqitura si më sipër.



II.4. Model i projeksionit të shitjeve pas investimit (*shembull excel*)

PERIUDHA	16-Jul	16-Aug	16-Sep	16-Oct	16-Nov	16-Dec	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
SHITJET									
Produkte									
Shërbime									
Të tjera									
TOTAL	0	0	0	0	0	0	0	0	0
KOSTO DIREKTE E SHITJEVE									
Produkte									
Shërbime									
Të tjera									
TOTAL	0	0	0	0	0	0	0	0	0
DIFERENCA	0	0	0	0	0	0	0	0	0



Shtojca III: KRITERET E VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE

Këto kritere përdoren nga autoriteti që kryen vlerësimin, nga ku vlerësimi maksimal për secilin projekt është deri në 100 pikë.

III.1. *Skema 1: “Mbështetje për projekte të NMVM për krijimin e zonave të përmirësuara të biznesit”:*

Kriteret detajohen në nënkriteret përkatëse nga autoriteti që kryen vlerësimin, bazuar në fushat në vijim:

1. Kontributi i projektit në planin e ndërhyrjes në zonë. Ky kriter vlerësohet nga **0 deri në maksimalisht 30 pikë**.
2. Ndikimi i projektit, lidhja me avantazhet konkurruese të zonës, efektin e pritshëm në punësim dhe në rritje të kapaciteteve të prodhimit apo shërbimit, vlera e shtuar. Ky kriter vlerësohet nga **0 deri në maksimalisht 30 pikë**.
3. Projekt – ideja/inovacioni i projektit, bazuar në analizën e tregut dhe të potencialeve konkurruese të zonës. Ky kriter vlerësohet nga **0 deri në maksimalisht 20 pikë**.
4. Kthyeshmëria e projektit, aftësia menaxhuese, për zbatimin me sukses të projektit, kapacitetet financiare dhe qëndrueshmëria e projektit. Ky kriter vlerësohet nga **0 deri në maksimalisht 20 pikë**.

III.2. *Skema 2: “Mbështetje për projekte të njësive ekonomike të njësive të qeverisjes vendore”:*

Drejtimet kryesore për projekte investimi për aplikim, janë për:

- a. Zhvillimin e rrjetëve tregtare dhe të shërbimeve të njësive ekonomike të njësive të qeverisjes vendore;
- b. Zhvillimin e aseteve dhe potencialeve ekonomike të zonave të tyre;
- c. Zhvillimin dhe rritjen e aftësisë sipërmarrëse të njësive ekonomike të njësive të qeverisjes vendore, lidhur me prodhimin, shërbimin dhe zinxhirin e vlerës, për të gjeneruar të ardhura dhe punësim.

Kriteret detajohen në nënkriteret përkatëse nga autoriteti që kryen vlerësimin, bazuar në fushat në vijim:

1. Kontributi i projektit në zhvillimin e potencialeve ekonomike të zonës në të cilin kryhet investimi. Ky kriter vlerësohet nga **0 deri në maksimalisht 30 pikë**.
2. Efekti i pritshëm i projektit në punësim dhe në rritje të kapaciteteve të prodhimit, shërbimit apo vlerës së shtuar. Ky kriter vlerësohet nga **0 deri në maksimalisht 30 pikë**.
3. Rritja e aftësive sipërmarrëse të njësive të qeverisjes vendore, potenciali për gjenerim të ardhurash, si dhe rritja e potencialeve konkurruese të zonës. Ky kriter vlerësohet nga **0 deri në maksimalisht 20 pikë**.
4. Kthyeshmëria e projektit, aftësia menaxhuese, për zbatimin me sukses të projektit, kapacitetet financiare dhe qëndrueshmëria e projektit. Ky kriter vlerësohet nga **0 deri në maksimalisht 20 pikë**.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë